

Dr. Ramiz ZEKAJ

TURQIA DHE PËRTËRITJA E ISLAMIT

Turqia - vendi me të cilin populli shqiptar bashkëjetoj mbi pesëqind vjet me radhë. Turqia muslimane e laike, sunite e alevite, Turqia europiane, bizantine, turanike, kurde etj, është e vështirë ta definosh me njëren nga këto përcaktime, pa i dhënë edhe tjetrës atë që meriton. Faqet e mëposhtme nuk kanë qëllim tjetër përveç paraqitjes së një përmbledhjeje të kulturës dhe të historisë turke gjatë periudhës paraislame, si dhe momentin e adoptimit të Islamit prej këtij kombi të madh.

Kultura paraislame turke

Një rishikim i përgjithshëm i zhvillimit historik dhe kulturor të popullit turk, gjatë një periudhe prej 2500 vjetësh, përpara adoptimit prej tyre të Islamit në shekullin X të erës sonë, do të zbulojë faktin se disa bashkësi turke i ruajtën edhe pas kësaj kohe besimet e tyre fetare, të cilat ata i kishin patur më parë.¹

Një nga problemet kryesore, i cili i ka angazhuar si turkologët vendas dhe ata të huaj për pothuajse 250 vjet në fushën e historisë turke, ka qenë zanafilla dhe kuptimi i fjalës "Turk", si dhe karakteristikat e popullit turk dhe atdheut të tyre.² Studiuesit kanë paraqitur një shumëllojshmëri pikëpamjesh në varësi të fushës së tyre të veçantë të interesit dhe të periudhave me të cilat ata janë marrë.

Pikëpamjet e pabazuara të disa studiuesve mesjetarë evropianë, në lidhje me prejardhjen mongoloide të turqve, janë diskutuar që në fillim të shekullit XX. E vërteta e çështjes ka qenë zbuluar nëpërmjet studimeve të bëra gjatë 20 apo 25 vjetëve të fundit të

shkullit XX mbi eshtrat e gjetura në *Kurgan*, në varret e ndërtuara në territoret e lashta turke në Azi. Megjithatë, duhet theksuar se turqit nuk kanë pasur asnjë lidhje të çfarëdoshme me mongolët, as gjuhësore, kulturore apo racore, as për sa i takon koncepteve të tyre të besimit dhe as ligjeve dhe qeverisë. Ngjashmëritë gjuhësore dhe të tipareve të fytyrës midis popujve turq dhe mongolë, që jetojnë në disa pjesë të Azisë, janë fryt i marrëdhënieve trashëguese dhe kontakteve të vazhdueshme etnologjike e gjuhësore të bëra gjatë periudhave të gjata të bashkekzistencës.

Referimet se turqit i përkasin racës kaukaziane, të bëra në burimet e lashta fetare si *Zend-Avesta* dhe *Testamenti i Vjetër*, të cilat i referohen Turkut (të birit të Jafethit, i biri i Profetit Nuh a.s.) janë vërtetuar nga studimet shkencore dhe hulumtuese të kryera gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit në shek XX. Përgjithësisht besohet se turqit i takojnë degës turaniane, racës së bardhë evropiane. Karakteristikat e tyre kryesore mund të përvijohen si vijon: lëkurë kafe, gjatësi mesatare (mesatarja 1.67 cm), fytyrë katrore, flokë të errët, formë koke brakicephalike, vetulla lehtësisht të anuara, mustaqe dhe mjekër të masës së mesme.

Studimet e fundit arkeologjike kanë hedhur dritë mbi problemin e atdheut të lashtë të turqve. Tashmë, përgjithësisht, besohet se rajoni i kulturës andronovite, në të cilin u gjetën skeletet që mbartin karakteristika raciale turke, ishte atdheu origjinal i tyre. *Kurganët*, të cilët i kanë ruajtur provat arkeologjike për kaq shumë shekuj, mendohet të kenë ekzistuar nga vitet 1700-1200 p.e.s. dhe kjo vërtetohet nëpërmjet teknikave me radiokarbon të datimit. Ky rajon, besohet që të ketë qenë djepi i "Kulturës së Stepave", i cili banohej nga popuj që i përkisnin kulturës afanasievite (vitet 2500-1700 p.e.s.), gjë e cila nuk pasqyron karakteristikat kulturore të turqve si kultura andronovite. Gjatë periudhës së viteve 1200-300 p.e.s., populli turk u shpërngul në territore të drejtimeve të mëposhtme: malet Urale dhe deti Kaspik në perëndim; vargmalet Tian Shan, Ma Vera En-Nehr, malet Altai, India Veriore; rajoni i Ordosit në Kinën Veri-Perëndimore në Lindje. Këto shpërngulje të shkaktuara qoftë nga zvogëlimi i kullotave dhe vështirësive ekonomike prej mbipopullimit, qoftë nga presionet që vinin prej bashkësive fqinje, sollën në rajone të ndryshme një numër variantesh dialektike në gjuhën e folur turke. Kështu tingulli "Y"

në turqishten origjinale ishte transformuar në "S", siç mund të shihet në dialektet e turqve jakut në Azinë Veri-Lindore. Më vonë, nga shekulli XIII p.e.s., një ndryshim i ri bashkëtingëlloreje ndodhi duke zëvendësuar tingullin "Z" me tingullin "R".

Përpara shfaqjes së tyre në skenën e historisë, siç tregojnë kronikat kineze, me emrin *Hiung-nu* (në turqishten e vjetër: hun = popull, hün = njeri) në rajonin që shtrihet midis Kinës Veri-Perëndimore dhe lumit Orhun në shekullin IV p.e.s., turqit përfundimisht kishin një organizim administrativ dhe ushtarak. Ndryshe, një lëvizje kaq e madhe e njerëzve, në distanca të mëdha për një periudhë prej 1200-vjetësh përpara shekullit IV, nuk do të kishte qenë e mundur. Megjithëse asnjë provë e besueshme nuk ekziston, disa studiues mbrojnë tezën (mbi bazën e disa vëzhgimeve të praktikave fetare), se dinastia Çou e Kinës (vitet 1050-256 p.e.s.), për shembull, ishte me origjinë turke; ndërsa disa studiues të tjerë, kanë pretenduar duke u përqendruar mbi fakte gjuhësore se sumerët, të cilët u shfaqën në Mesopotami në mijëvjeçarin III p.e.s., mund të ishin gjithashtu me origjinë turke.

Hunët e Azisë, lidhjet e të cilëve me turqit mund të provohen përtej çdo dyshimi, ishin bashkësia më e hershme politike turke në histori. Dokumenti më i vjetër i shkruar lidhur me këtë shtet, është teksti i një marrëveshjeje (viti 318 p.e.s.), të nënshkruar me shtetet fqinje. Megjithëse Alper-Tunga, udhëheqës i turqve që jetonin në Turan (pikërisht në tokat përtej lumit Jayhun [Oksus]) dhe komandant i ushtrive turke (të cilat luftuan me Kayhusraf-in, mbret i Persisë në vitin 550 p.e.s.) ishte përfundimisht një sundues turk.

Hunët, të cilët kishin një perandori të madhe, që periudhën e saj më të shkëlqyer e kishte pasur nën sundimin e Mo-Tun, në vitet 209-174 p.e.s. (turqisht: Beg-Tun = i biri i Beut) titulli mbretëror i të cilit ishte Tan-Hu (më vonë i shqiptuar: Shan-yu), ishin në gjendje që të mbanin pushtetin e tyre sa më larg të ishte e mundur. Gjatë mbretërimeve të pasardhësve të Mo-Tun-it, i biri i tij Kiok (Kök) dhe nipi i tij Kun-Chin, i cili jetoi nga fundi i shekullit II p.e.s., kufijtë e perandorisë shtriheshin nga *Mançuria* (e cila përfshinte Azinë Qendrore) deri në territoret që shtrihen përgjatë brigjeve lindore të detit Kaspik.

Duke mbledhur pothuajse të gjitha fiset turke nën një flamur të vetëm (duke vendosur një shembull për të gjitha shtetet e ardhshme turke me konceptin e tyre të qeverisë, strukturës shoqërore, jetës fetare dhe ekonomike, sistemet e tyre ligjore dhe ushtarake) hunët zënë një vend shumë të rëndësishëm në histori.

Duke hyrë në një periudhë rënieje me vdekjen e Kun-Chin, në vitin 126 p.e.s., hunët u ndanë në dy pjesë, në vitin 54 p.e.s. Më vonë, në vitin 48 p.e.s. njiheshin si hunët veriorë dhe jugorë, që ishte një ndarje përfundimtare mes tyre, për shkak të vështirësive ekonomike dhe grindjeve të dinastive. Të paaftë për t'i bërë ballë sulmeve të kinezëve dhe mësymjeve të His-yen-pi-ve mongolë nën nxitjen e të parëve, hunët veriorë u detyruan që të shpërnguleshin drejt Perëndimit dhe u shkatërruan në vitin 156 të e.s.; ndërsa hunët jugorë, të cilët u vendosën përgjatë kufirit kinez, vuajtën të njëjtën gjendje në vitin 216 të e.s.

Përveç shtetit të fortë Tabgaq, disa shtete të vogla të themeluara nga disa anëtarë të familjes së vjetër mbretërore vazhduan që të sundonin në mënyrë të pavarur në Kinë deri në fund të shekullit V. Shteti i fundit hun i këtij grupi vazhdoi që të sundonte, gjatë viteve 442-460 të e.s., përreth Turfanit. hunët veriorë, të cilët kishin lëvizur në drejtim të Perëndimit, të bashkuar me ogurët, kushërinjtë e tyre të vjetër dhe të mbeturit e hunëve nën sundimin e Çi-Çi Tanhus, të cilët humbën territoret rreth pellgut të lumit Talas (territore të fituara nga kinezët në vitin 36 p.e.s.) u detyruan që të lëviznin dhe prej tyre lindën hunët perëndimorë ose evropianë.

Pasi kaluan lumin Vollga, në vitin 374 të e.s. dhe shtypën rezistencën e gotëve, hunët perëndimorë vunë Evropën nën kontrollin e tyre brenda një periudhe të shkurtër kohe. Këta popuj turq luajtën një rol shumë të rëndësishëm në historinë e Romës, Evropës bizantine dhe kristiane, duke lënë ndikime të thella dhe jetëgjata në sferat politike, shoqërore dhe ushtarake.

Sundimtari i madh dhe i paharruar i hunëve perëndimorë, Atila (vitet 434-453 të e.s.) nënshtroi perandorin Teodosius i Dytë në dy ekspeditat që bëri në Ballkan (vitet 441 të e.s. dhe 442 të e.s.) dhe mundi forcat e bashkuara të romakëve dhe barbarëve nën komandën e Patricius Actus në fushën Mariacus, ose Katalana, afër Orleanit në Francë (20 Janar të vitit 451 të e.s.). Pasi i shkatërroi krejtësisht këto forca, Atila hyri në Itali vitin tjetër, pa hasur

qëndresë. Për të biseduar kushtet e paqes me të, si përfaqësues i Romës u dërgua Papa Leo i Parë. Kur Leo i Parë deklaroi se Roma ishte dorëzuar, rajoni që shtrihej nga Evropa Perëndimore deri në liqenin Bajkal në Azinë qendrore (duke mbuluar territoret e banuara nga rreth 25 fise të ndryshme, si: gjermanët, frankët, galët, finomarianët, persianët, etj.) u vu nën hegemoninë turke. Pas vdekjes së Atilas, në vitin 453 të e.s. kishte konfuzion në shtet dhe dy djemtë e tij u vranë kundër shtetasve rebelë (vitet 454 dhe 459). Disa hunë nën udhëheqjen e Irnekut, djali më i vogël i Atilas, lanë territoret dhe u bashkuan më ogurët, një popull i Detit të Zi, i njëjtë me ta nga përkatësia racore.

Megjithëse ekzistenca e tyre politike zgjati për rreth një shekull, hunët lanë një ndikim të thellë në historinë e Evropës duke filluar shpërnguljet fisnore, duke i dhënë fund periudhës romake dhe duke sinjalizuar ardhjen e mesjetës, si dhe shtruar rrugën për krijimin e Perandorisë së Shenjtë Romake. Përveç këtyre roleve me pasoja politike dhe etnike, hunët kontribuan gjithashtu nëpërmjet marrëdhënieve paqësore apo luftëdashëse me fqinjët e tyre për zhvillimin e eposeve të tillë si ai Nibelungëve, por edhe legjendave të tilla, si: Shenjti Lupus dhe Shenjta Gjeneviev, të cilat ushtruan një ndikim të madh mbi kulturën europiane. Nëpërmjet përhapjes së idealit të fisnikërisë, ata dhanë një kontribut domethënës për jetën shoqërore të Evropës mesjetare.

Adoptimi i Islamit nga turqit

Adoptimi i besimit islam nga turqit është një ngjarje me përmasa të jashtëzakonshme, jo vetëm nga pikëpamja e historisë turke dhe islame, por edhe e historisë botërore në përgjithësi. Turqit e pranuan besimin e ri, jo nga mbetja nën hegemoninë politike të shtetit islam, por pas një periudhe të gjatë familjariteti me të.

Kontaktet e para të turqve më botën islame fillojnë me pushtimin e Iranit nga arabët muslimanë, që pasoi betejën e Nihavandit, e cila u zhvillua në vitin 21/642. Megjithatë, edhe përpara kësaj date, turqit dhe arabët, megjithëse jetuan në rajone të ndryshme të botës, arritën të kenë një njohje të lehtë me njëri-

tjetrin nëpërmjet Mbretërisë Sasanide. Kështu Nabiga Dhubjani, Hassan bin Handhala, Avs bin Haxher dhe Shammah bin Dirar, poetë arabë të periudhës së xhahilijetit i referoheshin vazhdimisht në poezitë e tyre cilësive ushtarake të turqve.

Në disa transmetime, të cilat janë përfshirë në përmbledhjet më të njohura të haditheve, ka gjithashtu referenca për karakteristikat ushtarake të turqve: “*Mos i bezdis turqit për aq kohë që ata nuk të ngasin*”, “*Unë kam ushtarë të quajtur ‘turq’ në Lindje*”, “*Turqit do të vijnë në ‘Amīd, do të pijnë ujë nga lumenjtë Tigrër dhe Euftrat dhe do të bredhin nëpër xhezire*”. Shembuj të tillë hadithesh janë të shumtë dhe dihet që këto thënie datojnë që nga kohët më të hershme të Islamit. Përfshirja e tyre në *Kutub al Sit-te* dhe përmbledhje të tjera të besueshme të hadithit, ia shtojnë forcën vërtetësisë së tyre. Taberiu përmend se Profeti Muhamed ishte në tendën turke, ndërsa muslimanët po përgatiteshin për Betejën e Hendekut. Ndërkohë që Muslimi, studiuesi i famshëm i haditheve, shënon se Profeti ishte për *i’tikaf* në tendën turke. Në *Fada’il El-Atrak*, Xhahidhi, një historian i mirënjohur arab, e vë theksin te mjeshtëritë ushtarake të turqve.

Kontaktet më të hershme midis muslimanëve dhe turqve ndodhën në Horasan dhe veçanërisht, në *Mavera en-Nahr* (Transoksiana) dhe Kaukaz, në vijim të pushtimeve të ndërmarra gjatë kohës së Kalifit të dytë Omerit r.a. (vitet 13-23/634-644). Ubeidullah bin Ziad (në kohën e Kalifit Emevit Muaviut), guvernatori i Horasanit kaloi lumin Amurdaria (Oksus ose Gjaihun, në vitin 541/647), i cili formonte kufirin midis Iranit dhe Turanit dhe ngritën rrethimin në Buhara, një nga qytetet e rëndësishme të Transoksianës, që atëherë ishte e sunduar prej një grupi bejlerësh turq. Pas përfundimit të një traktati me Kabaj Hatun (sunduesi turk i qytetit, Ubejdullahu) u largua nga rajoni me 2000 ushtarë turq. Transoksiana, e cila sundohej nga një numër bejlerësh të pavarur turq dhe që ishte shfaqur gjatë rënies së shtetit Gok-Turk, ishte pjesërisht e pushtuar nga arabët gjatë periudhës kur Kutejbe bin Muslim ishte guvernator i Horasanit (vitet 86-96/705-715). Por ndikimi i emevitëve në rajon, prirëj që të dobësohej pas Kutejbes. Ndër shkaqet e dështimeve të arabëve në këtë front ishin:

- 1) Rifillimi i rivalitetit midis fiseve arabe.

2) Keqqeverisja e guvernatorëve të tyre.

3) Bashkimi i bejlerëve turq në Transoksiana kundër armikut të përbashkët.

4) Të qenurit e tyre nën mbështetjen nga Hanati i Turgishit, i cili ishte shfaqur si një shtet i fuqishëm i asaj kohe.

Luftimet e përgjakshme në Kaukaz, të cilat filluan gjatë kohës së Kalifit Omer r.a. dhe vazhduan herë pas here për disa kohë, provuan që të ishin të palogjikshme për të dyja anët në lidhje me fitimin e territoreve. Fitorja më e rëndësishme muslimane në këtë front ishte ekspedita gjatë të cilës Itili (Atil), kryeqyteti i hazarëve u rrethua nga Mervan bin Muhamedi, guvernatori i Azerbajxhanit dhe Armenisë, në vitin 737 dhe si përfundim Hani i Hazarit pranoi Islamit.

Në vitet e hershme të *Dinastisë Abasite*, luftërat dhe operacionet në pothuajse të gjitha frontet, si edhe me turqit, ose humbën hovin ose pushuan krejtësisht. Me trashëgimin e Kalifatit nga abasitët, duke u pasuar me një numër zhvillimesh që ndodhën në Lindje, konflikti njëshekullor midis arabëve dhe turqve mori një përmasë të re. Ndërkohë që lufta turko-arabe në Transoksiana vazhdonte, disa bej turq kërkuuan ndihmë nga Kina kundër armikut të tyre të ri. Duke e konsideruar këtë ftesë si një rast të mirë për të vënë hegemoninë e tyre në Turkistan, Kina filloi të përparonte drejt Perëndimit me një ushtri të madhe në vitin 129/747. Por mizoria e kinezëve dhe veçanërisht vrasja e Bagatur Tudunit, beu i Tashkendit, i çoi turqit të kërkonin ndihmë nga Ebu Muslimi (guvernatori Abasit i Horasanit). Duke pranuar menjëherë kërkesën turke, Ebu Muslimi dërgoi një ushtri të madhe nën komandën e Zijad bin Salihit kundër forcave kineze. Forca e bashkuar turke dhe arabe u përplas me ushtrinë kineze përgjatë brigjeve të lumit Talas pranë *Alma-atës* së sotme, në vitin 143/751. Duke pësuar dëme të shumta në një betejë 5-ditore, kinezët braktisën fushën në dhulhigje të vitit 134 (në korrik të vitit 751).

Beteja e Talasit shënoi një pikë kthese në marrëdhëniet turko-arabe, sepse i dha fund një periudhe të gjatë armiqësie dhe i dha shtytje një periudhe paqeje dhe marrëdhëniesh tregtare; duke përgatitur kështu terrenin për përhapjen graduale të besimit islam te turqit.

Turqit në sundimin e dinastisë Abasite

Një numër ndryshimesh të rëndësishme ndodhën në politikën e brendshme dhe të jashtme të shtetit islam me shfaqjen e dinastisë Abasite. Politika e nacionalizmit arab e ndjekur nga dinastia Emevite u braktis dhe çdo muslimani iu njohën të drejtat e barabarta, pavarësisht origjinës së tyre etnike. Persona të origjinës joarabe, të cilët luajtën role të rëndësishme në revolucionin që solli rënien e dinastisë Emevite, zunë poste të larta në administratën e shtetit. Posti i vezirit, i cili ishte krijuar fillimisht nga dinastia Abasie dhe detyra të tjera të rëndësishme civile e ushtarake, ishin plotësuar nga iranianët. Pa dyshim, midis tyre duhet të ketë pasur disa turq edhe pse mund të ketë qenë një numër i vogël. Muhamed bin Seul, një nga komandantët Abasit, Tarhun bin El-Zai, i cili bënte propagandë në favor të dinastisë Abasite në Marë dhe Tarhun El-Xhamal, një nga njerëzit e besuar të Ebu Myslimit, ishin ndër turqit e parë që do të dalloheshin në sundimin e Abasit.

Ndikimi dhe numri i turqve në organizimin e shtetit u rrit gradualisht. Burimet historike vënë në dukje se Xhafer El-Mensuri ishte i pari kalif që përfshiu turqit ndër njësitë e tij ushtarake. Garda e kalifit Harun El-Rreshid dihet që përbëhej krejtësisht nga turqit. Gjithashtu, dihet se kishte turq ndër radhët e trupave të vendosura përgjatë kufirit me Bizantin, i cili ishte përforcuar gjatë mbretërimit të Harun El-Rreshidit dhe se Ebu Sulejm Ferexhit iu caktua detyra e fortifikimit të disa qyteteve. Mosmarrëveshja mbi të drejtën e trashëgimisë së Kalifatit, e cila filloi midis El-Eminit dhe El-Me'munit, bijtë e Harun El-Rreshidit, pas vdekjes së tij (viti 193-809) dhe ngjarjet e viteve që pasuan e detyruan El-Ma'munin të bënte ndryshime në shkallë të gjerë ndër zyrtarët e qeverisë së tij.

Në kohën e sundimit Abasit, iranianët filluan të zinin postet më të larta qeveritare. Lufta midis El-Eminit dhe El-Me'munit ishte në një farë mënyre, shprehje e një konflikti midis dy popujve, iranianëve dhe arabëve. El-Me'muni, i cili ishte sjellë në Kalifat me mbështetjen e iranianëve, e kuptoi shumë më përpara, veçanërisht nëpërmjet udhëzimeve të vezirit të tij, Fadl bin Sehlit, se politika që ai ndiqte ishte e gabuar dhe duhej të adoptonte një qëndrim armiqësor ndaj iranianëve. Në këtë situatë, atij i duhej një forcë

e re ku mund të mbështeste besimin e tij. Kalifi El-Me'mun nuk u zgjat shumë në gjetjen e kësaj force. Ai mendoi për turqit, të cilët i kishte njohur mirë gjatë qeverisjes së Horasanit. Ata zotëronin mjeshtërinë ushtarake dhe përvojën administrative, të cilat nevojiteshin për të mbushur boshllëkun e pushtetit në shtetin islam. Gjatë viteve të fundit të kalifatit të tij, El-Me'muni e bëri praktikë të rregullt të rekrutonte mercenarë turq nga tokat turke. Një forcë ushtarake, e përbërë nga 18.000 turq, u formua në Bagdad brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe. Siç shihej qartë në ekspeditat e nisura nga El-Me'muni kundër Bizantit, kjo forcë formonte bërthamën e ushtrisë së Kalifatit, e cila ishte nën komandën e El-Afshinit, Ashnas El-Turkit, Buga El-Kebirit dhe komandantë të tjerë turq.

Gjatë mbretërimit të El-Mu'tesimit (vitet 218-277/833-842), vëlla dhe pasardhës i El-Ma'munit, turqit e kishin përcaktuar në mënyrë edhe më të qëndrueshme, duke forcuar pozitën e tyre në ushtrinë Abasite. Kur u themelua qyteti i Samarras në vitin 836, Kalifi u vendos atje me gardën e tij dhe e bëri atë kryeqytetin e tij të ri. Trupave turke iu ishin caktuar lagje të veçanta në Samara. Kalifi El-Mu'tesim iu dha disa privilegje ushtarëve turq në shërbim të tij, të cilët numëronin rreth 25.000. Ata ndryshonin nga trupat e tjera në uniformën e tyre dhe në shumën e pagave të tyre. Gjatë periudhës së gjatë të prej më shumë se 50 vjet e njohur si "Periudha e Samaras" (vitet 221-279/836-892) në historinë islame, turqit po fillonin të zotëronin ndikim të konsiderueshëm jo vetëm në çështjet ushtarake, por gjithashtu dhe në ato politike dhe administrative të shtetit. Madje dhe vetë kalifët zgjidheshin nga komandantët turq dhe duhej të vepronin në përputhje me kërkesat dhe dëshirat e tyre, edhe pse ndërkohë po përpiqeshin që të çliroheshin nga presioni i komandantëve turq. Pasojat e këtij rivaliteti u vuajtën rëndë nga të dyja palët. Rivendosja e kryeqytetit në Bagdad në vitin 279/892, e dobësoi ndikimin turk mbi administrimin e shtetit në një farë mase, por kur kalifi El-Radi emëroi Ibn Ra'ik El-Hazarin si "Emir el-Umera" me fuqi të zgjeruara në vitin 324/936, turqit e rifituan ndikimin e tyre të mëparshëm në oborrin e Abasitëve. Ky ndikim u shtua sidomos gjatë periudhës kur Bekhemi dhe Tuzuni mbanin postin e *Emir El-Umera*. Kur Bagdadi u pushtua nga Buvahidët Shi'it në vitin 344/945, kalifët Abasit ishin krejtësisht

të privuar nga forca e tyre politike. Ata u çliruan prej shtypjes Buvahide me ardhjen e Selxhukëve.

Fillimi i përhapjes së Islamit te turqit

Fillimisht Islami u pranua nga populli turk në ato toka të cilat ishin vënë tashmë nën sundimin e shtetit Islam. E para prej këtyre tokave ishte Transoksiana, e cila ishte e pushtuar pjesërisht nga Kutejbe bin Muslimi, që ishte përpjekur të përhapte Islamin ndërsa merrte masat e nevojshme për të sjellë territoret që ai pushtonte nën kontrollin e tij të fortë ushtarak. Faktikisht, një xhami ishte ndërtuar në Buhara, pasi ishte pushtuar përfundimisht në vitin 94/713. Nga ana tjetër, ndërsa po negocioheshin kushtet e dorëzimit të Samarkandit, qyteti i dytë nga madhësia i Transoksianës, muslimanët këmbëngulën se ndërtimi i një xhamie në qytet nuk duhej të kundërshtohej. Kutejbe mbikëqyri ndërtimin e xhamisë personalisht dhe mori masa të forta për të parandaluar ndonjë reagim armiqësor nga banorët vendas. Pavarësisht nga të gjitha këto përpjekje, Islami nuk ishte popullor siç tregohet nga fakti se u ishte premtuar pagesë atyre që ndiqnin Namazin e Xhumasë (Faljen e mesditës së të Premtes) në xhami. Kuteibe bin Muslim nuk ia doli mbanë të arrinte të njëjtën shkallë suksesi në përhapjen e besimit islam, si me vendosjen e hegjemonisë së tij ushtarake në territoret e pushtuara. Ky dështim ishte shkak i politikës së përgjithshme të ndjekur nga Kalifati Emevit, më tepër sesa nga drejtimi i Kutejbes. Banorëve jomuslimanë në territoret e pushtuara, të cilët e kishin pranuar Islamin nga kjo politikë e Emevitëve, u kërkohesh që të paguanin të gjitha llojet e taksave me qëllim që të rrisnin të ardhurat e shtetit. Për më tepër, ata shërbenin në ushtri si këmbësorë, merrnin më pak rrogë dhe plaçka lufte, sesa kalorësit arabë. Kjo gjë po e parandalonte përhapjen e Islamit.

Gjatë sundimit të Kalifit Sulejman (vitet 99-101/715-717) i cili pasoi Velidin e Parë, Jezid bin Muhal-lebi, guvernator i Horasanit, pushtoi Xhurjanin dhe kapi rob Sulteginin, sundimtarin e këtij rajoni. Më pas Sultegini u bë musliman, hyri në shërbimin e Jezidit dhe u vra në Betejën e *Akrës* duke luftuar me Jezid bin Muhal-lebin, i cili kishte ngritur krye kundër sundimtarit të tij Jezidit të Dytë (viti 102/720). Megjithatë nuk mund të supozohet se vetëm

ky incident çoi në konvertimin e krejt banorëve të territorit të Xhurjanit në Islam.

Islami bëri një përparim të konsiderueshëm në Transoksiana gjatë mbretërimit krahasimisht të shkurtër të Omer bin Abdu-l-Azizit (vitet 99-101/717-720). Në udhëzimet që Omeri u dërgoi guvernatorëve të tij, ai paralajmëroi që të mos mblidhnin xhizjen (taksë për kokë e mbledhur nga jomuslimët) prej atyre që e kishin pranuar besimin musliman. Me gjithë këto paralajmërime të qarta guvernatorët vendorë vazhduan praktikat e tyre të zakonshme. Në fakt, një delegacion udhëtoi gjithë rrugën për në Damask për t'u ankuar për guvernatorët e Kalifit. Me vdekjen e Omer bin Abdu-l-Azizit kjo politikë u braktis dhe muslimanëve në këto toka iu kërkohesh përsëri të paguanin xhizjen. Nga ana tjetër, Hanati i Turgishit i cili kishte fituar fuqi mbi rënien e shtetit gok-turk ishte angazhuar në një luftë të hidhur me popullin musliman të Transoksianës. Faktikisht, turqit jomuslimanë ishin triumfues për disa kohë dhe Islami në Transoksiana ishte në rrezik. Gjatë kalifatit të Hishamit (vitet 105-125/724-743), Eshres bin Abdullah, guvernatori i Horasanit caktoi Ebu El-Sheyde bin Ta'rif dhe Imran El-Temimin për përhapjen e Islamit te turqit dhe këta persona u përpoqën shumë që t'i bënin për vete Turqit brenda dhe jashtë Samarkandit. Gjatë kësaj kohe në Belh, në vitin 124/742, u ndërtua një xhami.

Ndër dinastitë e njohura turke të asaj kohe, si: Ihshidit, Ejlekit dhe Gaznevit, i qëndruan gjithmonë besnike kalifatit për dallim nga dinasti të tjera me origjinë persiane dhe arabe. Kalifi El-Kadir, Gaznevitë i konsideronte dorë e djathtë të shtetit (jeminud-devle), por në zhvillimet për islamizimin e popullit turk rëndësinë më të madhe e luajti dinastia turke e Selxhukëve, e cila i qëndroj besnike mësimëve të Islamit. Për një farë kohe ata sunduan edhe Bagdadin nga i cili nxorën jashtë Buvejhinë, që patën një rol të theksuar në dobësimin e kalifatit.

Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se Islami hyri në shumë pak toka turke prej dominimit ushtarak. Pranimi i fesë nga turqit pa përdorimin e forcës është ajo që i bëri ata më vonë përhapësit më të mëdhenj të saj. Mund të ishte me vlerë të shqyrtoheshin shkurtimisht shkaqet e pranimit të Islamit prej turqve pa detyrim.

Shkaqet e pranimit të Islamit prej turqve

Përpara pranimit të Islamit, turqit kishin hyrë në kontakt me një shumëllojshmëri fesh dhe disa fise turke i kishin pranuar disa prej tyre. Te turqit, fetë si ebreizmi, kristianizmi dhe budizmi kishin gjetur pak përkrahës. Në fakt, bashkësitë turke veçanërisht në nivelin e politikanëve demonstroi reagim të fortë kundër depërtimit të këtyre feve në territoret e tyre, ndërsa nuk tregoi ndonjë kundërshtim ndaj Islamit. Mihaili, (vdekur në vitin 1199) një teolog dhe historian Nestorian i shekullit XII shpjegon qëndrimin e favorshëm të turqve dhe pranueshmërinë e tyre të etshme të Islamit, si një fryt i besimit të tyre tradicional në një hyjni të vetme, të cilën ata e identifikonin me besimin e arabëve muslimanë, pikërisht besimin në Allahun. Ky vëzhgim i Mihailit është vërtetuar nga fakti i sigurt historik se që nga shekulli III p. e. s. e këtej, turqit besonin në Gok-Tenrin (Zoti i Qiellit) e përjetshëm, një fuqi hyjnore dhe sundimtar absolut i gjithësisë dhe fatit të njeriut. Pra, turqit ishin në gjendje që ta identifikonin lehtësisht konceptin e tyre të Zotit me 'Allahun' e Islamit. Për më tepër, turqit gjetën një ngjashmëri midis konceptit të tyre të pushtimit të botës dhe idealit Islam të Xhihadit, që është lufta për çështjen e fesë (Lufta e Shenjtë).

Në virtytet e Xhihadit dhe shpërblimet e premtuara në jetën e përtejme të Muxhahidinëve (ushtarëve të Islamit), turqit gjetën idealet e tyre. Përpara Islamit, sipas besimeve të turqve atyre u ishte dhënë premtimi se do të shpërbleheshin në parajsë sipas numrit të armiqve që ata vrisnin, i cili ishte i ngjashëm me pikëpamjen islame të Muxhahidinëve turq për të pranuar fenë e re. Citatet në përmbledhjet e haditheve rreth turqve, ndihmuan për të kalitur një ndjenjë simpatie të turqit për Islamin. Në procesin gradual të transformimit Kamët (e kohës paraislame) me fuqitë e tyre parashikuese dhe kryerjes së mrekullive, u zëvendësuan nga myftinjët dhe murshidët, udhëheqës shpirtërorë ose mësues dhe ky ndryshim ndodhi pothuajse pa u vënë re. Kishte ngjashmëri të mëdha midis mënyrës turke të jetesës dhe rregullave të vëna në një shoqëri nga Islami. Pikat e përmendura më sipër mund të shpjegojnë deri në një farë mase, pse turqit synonin që të pranonin kaq shpejt besimin e ri? Ata e panë fenë dhe qytetërimin islam që ishin në harmoni të përsosur me idealet dhe botëkuptimin e

tyre. Entuziazmi për idealin e përhapjes së fjalës së Zotit, duke nënshtruar vende të reja, e ka aktivizuar më vonë tërë shoqërinë turke të përfaqësuar më në fund me osmanlinjtë.

Turqit bëhen mbrojtësit e Islamit në botë

Dihet tashmë se *periudha e parë* islame ka filluar me fiset arabe në Mekë e Medinë, që pasi pranuan islamin dhe e zgjeruan atë prej Siujdhesës së Arabisë në Irak, Persi, Siri (Sham), Egjipt, në Afrikën Veriore dhe në Andaluzi. Ndërsa *periudha e dytë* konsiderohet ajo e filluar me turqit selxhukë dhe berberët, që pasi pranuan Islamin e përhapën atë në Azinë e Vogël, Afrikën Perëndimore, dhe në Lindje deri në veri të Indisë, në kohën e Sulltan Mahmud Gazneviut. *Periudha e tretë*, fillon me turqit osmanlinj, që e kishin pranuar Islamin dhe kishin formuar shtetin e tyre në Azi të Vogël në pjesën veriperëndimore të botës islame.

Rolin më të hershëm dhe më të theksuar të turqve në botën Islame e hasim gjatë mbretërimit të shtetit të Abasitëve. Që nga koha e Kalifit El-Me'mun ata luajtën një rol të rëndësishëm në shtypjen e kryengritjeve, si dhe në kryerjen e ekspeditave kundër Bizantit.

Shenja të shpërbërjes filluan të dukeshin në botën Islame që nga fillimi i shekullit X e këtej. Autoriteti i kalifëve Abasitë, të cilët përfaqësonin qeverinë qendrore respektohej vetëm në Bagdad, kryeqytetin e tyre. Provincat lindore të vendit të tyre ishin nën sundimin e Samanidëve, ndërsa në Siri Hamanidët kishin fituar pavarësinë e tyre (viti 317/929). Edhe më të rrezikshëm se këta ishin Karamitët, të cilët u shfaqën në Bahrein në vitin 286/899 dhe e vendosën autoritetin e tyre në Hixhaz dhe Siri brenda një periudhe të shkurtër kohe. Ata kishin shkuar deri aty, sa të mbartnin Haxher El-Esvedin (Gurin e Zi) nga Qabeja në Ahsa dhe kalifati Shi'it Fatimi. Ky kalifat ishte themeluar në Tunis, në vitin 295/908, që më pas morën Kajron në vitin 969 dhe më vonë, e shtrin hegjemoninë e tyre mbi krejt Afrikën Veriore, Egjipt, Siri dhe Arabinë Perëndimore. Buvahidët pushtuan Bagdadin në vitin 333/945. Prishja e unitetit politik shtroi rrugën për krizë ekonomike. Ndërsa bota Islame po shpërbëhej, Perandoria e Bizantit po forcohej, duke zbatuar një politikë agresioni kundër

Islamit dhe duke pushtuar territore të reja.

Këtë kohë kur Islami po shpërbëhej dhe po kalonte nëpër një fazë kritike në historinë e tij, u shfaq një forcë e re që njihet me emrin *Shteti Selxhuk*. Duke fituar pavarësinë në vitin 429/1038 dhe pastaj duke u bërë fuqia e vetme politike në Iran, pas Betejës Dandanakan në vitin 431/1040, shteti Selxhuk e çliroi Bagdadin nga zotërimi i Buvahidëve, riktheu prestigjin e kalifëve Abasitë dhe me ekspeditat që ata bënë kundër Bizantit i ridhanë jetë shpirtit të vjetër të Xhiladit. Megjithëse ekspeditat kundër Anadollit kishin filluar gjatë kohës së Kalifit Umer dhe vazhduan gjatë shekujve të mëpasshëm, pushtimi i tij nuk u arrit deri në vitin 1071, kur ushtria Selxhuke nën komandën e Alp Arslan arriti një fitore të rëndësishme ndaj ushtrisë Bizantine në Malazgirt (24 Dhu-l-ka'da të vitit 463/ 26 gusht i vitit 1071). Kjo fitore shënoi një pikë të rëndësishme në kthimin e Anadollit në një territor turk dhe Islam.

Pushtimi i Anadollit, Sirisë, Palestinës dhe veçanërisht i Kudsit (Jeruzalemit) nga turqit shkaktoi tension të madh në Evropën kristiane. Të nxitur dhe inkurajuar nga Papa Urbani i Dytë, fuqitë kristiane dërguan ushtri të mëdha të njohura si “Kryqëzatat”, nëpërmjet Anadollit dhe Sirisë për në Palestinë. Turqit ishin forca kryesore që luftonte, madje edhe e vetme, kundër këtyre ushtrive. Pas pushtimit dhe plaçkitjes së Kudsit nga ushtritë e kryqëzatatave dhe masakrimit të popullit të tij, në vitin 492/1099, u krijuan një numër shtetesh të vogla kristiane dhe dukatash në Lindjen e Afërme. Në luftën e furishme dhe të vazhdueshme të filluar nga fuqitë muslimane për të eliminuar këto shtete të cilat ishin themeluar në territoret që muslimanët i posedonin në shekuj, ushtritë e kryqëzatatave gradualisht, pasi hasën në rezistencën e paepur nga popujt Islamë, filluan që të zmbropseshin. Kështu Imadu-d-Din Zenki rimori Urfan (Edesen) nga kryqëzuesit në vitin 539/1144 dhe Salahu-d-Din Ejubi mori Kudsit në vitin 583/1187. Sulltan Bajbarsi, sunduesi i Dinastisë Memalike turke në Egjipt, shfarosi një nga një të mbeturit e ushtrive kristiane në qytetet bregdetare të Sirisë. Një tjetër shërbim i madh që Sulltan Bajbarsi i bëri Islamit ishte fitorja e tij në Ajn Xhalut në vitin 658/260 ndaj ushtrisë mongole, e cila kishte shkaktuar rrënim tejetmbanë Turkistanit, Irakut dhe Iranit dhe po lëvizte në drejtim

të Perëndimit. Kjo fitore e Bajbarsit e ndaloi këtë kërcënim nga mongolët. Bedru-d-Din el-Ajni, një historian i njohur mesjetar, e përshkruante fitoren e Ain Xhalutit si: “Shpëtimin e Islamit nga Mongolët prej Turqve”. Për më tepër, Bajbari ftoi në Kajro Ahmedin, të birin e Dhahirit, i cili kishte shpëtuar nga masakra mongole në Bagdad dhe kishte marrë azil në Damask, dhe e shpalli atë si kalif, me titullin e El-Muntasir Bil-lah në 29 Rexhep të vitit 659/ 9 Qershor të vitit 1201. Kështu, ai ringjalli Kalifatin Abasit, i cili kishte marrë përsipër udhëheqjen shpirtërore për pesë shekuj. Më vonë, në shekullin XIV, këtë rol do ta merrte për shumë shekuj Perandoria Osmane.

Pranimi i Islamit nga turqit ishte një ngjarje që do të luante një rol shumë të rëndësishëm në fatin e tyre. Pranimi i një besimi apo civilizimi të ri është gjithmonë i rëndësishëm në historinë e një kombi përderisa fut një seri ndryshimesh dhe zhvillimesh shpirtërore, shoqërore dhe intelektuale. Historia është plot me shembuj kombesh që arrijnë lartësi të jashtëzakonshme në përparimin material dhe zhvillimin shpirtëror, nëpërmjet pranimit të një besimi të ri. Nga ana tjetër, shembujt e durimit të mjerimit dhe përbaljes me zhdukjen kombëtare, janë parë si rrjedhojë e së njëjtës arsye. Historia turke ka dëshmi të bollshme për çfarë mund të sjellë ndryshimi i një besimi në jetën e një kombi. Përpara pranimit të Islamit, turqit kanë qenë në kontakt me fe të tilla si budizmi, maniceismi, judaizmi dhe kristianizmi, të cilin ata e kishin pranuar pjesërisht, megjithëse shumica e tyre kishin mbetur besnikë të fesë së tyre të bazuar në adhurimin e Gok-Tanrit (që është Zoti i Qiellit). Besimet e tjera të radhitura më sipër nuk harmonizoheshin me zakonet dhe mënyrat e jetesës së turqve. Këto besime prireshin që të shkatërronin identitetin fisnor dhe ndërgjegjen kombëtare turke brenda një kohe të shkurtër. Kur Bilge Kagan, sundimtari Gok Turk, kërkonte që të ndërtohej një tempull budist, Tonyokoku, veziri i tij, kundërshtoi duke i tërhequr vëmendjen e sundimtarit ndaj faktit se pranimi nga turqit i “një feje që ndalonte luftën dhe ngrënien e mishit të kafshëve, si dhe inkurajonte dembelizmin dhe pasivitetin, do të kishte një efekt shkatërrues mbi ta”. Politikanit largpamës iu dha të drejtë në shqetësimin e tij për këtë çështje.

Duke pranuar Islamin, turqit fituan një forcë dhe vitalitet të ri,

që ata i përdorën si avantazh për themelimin e shteteve të mëdha në territoret, që nga stepat e Azisë deri në zemër të Evropës. Koncepti islamik i ligjit dhe rregullit harmonizoheshin kaq mirë me zakonet tradicionale turke, sa këta të fundit e ruajtën identitetin e tyre kombëtar; ndryshe nga hungarezët, bullgarët, hazarët dhe peçenegët. Asnjë nga fiset turke, të cilat kishin pranuar Islamit nuk e humbi identitetin e tij kombëtar. Me fjalë të tjera, për arsye të Islamit, turqit muslimanë, kudo që mund të kenë qenë shpërndarë, ishin në gjendje ta ruanin ekzistencën e tyre kombëtare. Ky efekt i Islamit u demonstrua në çdo sferë të veprimtarisë njerëzore, që nga administrimi i shtetit deri tek arti, kultura etj., duke u bërë një burim frymëzimi në krijimin e veprave të panumërta të bukuri së përjetshme. Sot të gjithë turqit (me përjashtim të 1-2 milionëve) rreth 150. 000 000 kanë përqaftuar Islamit si fenë e tyre dhe Islami është bërë karakteri i një besimi kombëtar për turqit prej mëse nëntë shekujsh.

Shënime:

¹ Për përgatitjen e këtij materiali jemi mbështetur në studimin e një grupi autorësh me titull "A short history of Turkish - Islamic state", përkthyer në gjuhën angleze nga Ahmet Edip Uysal, botuar në Ankara në vitin 1994.

² Si një emër i përgjithshëm fjala "Turk" do të thotë "forcë" ose "fuqi" dhe si mbiemër nënkupton një njeri të fuqishëm dhe energjik. Fjala ishte përdorur në këtë kuptim së pari në një dokument persian (viti 420 i e.s.) që nga gjysma e parë e shek.V të e.s. dhe më vonë në një burim bizantin (viti 515 i e.s.). Disa studiues mbështesin se fjala rridhte ndoshta nga *Tu-ku* ose *Tu-k'o*, emri i familjes ose fisit të Mo-tun, perandori i hunëve në Azi p.e.s. Me themelimin e Hënate të Gök-Türkut në vitin 552 të e.s., në Azi fjala ishte përdorur si emër i shtetit dhe me kohë u bë e përhapur si emri i përgjithshëm i të gjithë popujve që rridhnin nga raca turke, që flisnin gjuhën turke dhe ndanin të njëjtën trashëgimi kulturore turke. Fjala "Turkiye" (që do të thotë "toka në të cilën jetojnë Turqit"), u përdor për herë të parë për Azinë Qendrore në veprat e Menandros, një historian bizantin i shek.VI dhe për rajonin që shtrihet ndërmjet Hungarisë dhe detit Kaspik gjatë periudhës midis shekujve VIII dhe X. Fjala u përdor më vonë për Egjiptin dhe Sirinë në burime historike islame gjatë shekujve XIII dhe XIV dhe për Anadollin në kronikat perëndimore mbi kryqëzatat nga shekulli XII e këtej. (Shih. Dilip Hiro, Dictionary of the Middle East, f.327).

³ Antropologët kanë vënë në dukje se karakteristikat që i dallojnë turqit nga mongolët me lëkurë të verdhë dhe formë koke dolioccephalike dhe nga racat

mesdhetare dhe indo-europiane që kanë formë koke doliococefalike. Tipi i vërtetë turk u zbulua nga studimi i skeleteve të gjetura në një rajon në Veri-Perëndim të Liqenit Bajkal në stepat të Minusinsk, një rajon i njohur si kultura e Andronovës, ku turqit njihen që të kenë jetuar që në kohët parahistorike.

⁴ Ky diferencim gjuhësor faktikisht çoi në shfaqjen e dy popujve të ndryshëm turq secili me fatin e vet historik. Këto dy ndarje përfshinin:

a) Turqit lindorë që përdornin Z në vend të R: Hunët e Azisë, Europës dhe Lindjes së Mesme, tabgabch-ët, gök-turqit, ujugurë, turqishët, karlujkët, hazarët, pechenegët, kuman-kupchakët, oguzët, selxhukët, principatat e Anadollit (Bejlerët), otomanët, turqit e Anadollit;

b) Turqit perëndimorë që përdornin R në vend të Z: Oguzët, bullgarët, dhe chuvashët që tashme jetojnë në rajonin e Kazan-it. Ndër këto shpërngulje, shkaqet dhe kushtet, të cilat janë të mirënjohura për historianët, ato të hunëve dhe oguzëve janë të rëndësishë së madhe jo vetëm nga pikëpamja e distancave të mbuluara dhe territoreve të zëna, por në të njëjtën kohë sepse ato kanë karakterin e pushtimit në kuptimin e duhur të fjalës. Fillimisht duke filluar mbi një bazë individuale si në rastin e të rinjve Turq që ishin të shëndetshëm dhe që zinin punë si mercenarë në shërbim të ndonjë force të huaj. Ato më vonë morën natyrën e shpërnguljeve masive të turqve drejt vendeve islame. Me fjalë të tjera, çfarë dukej si depërtim i rastësishëm në fillim, në kohë ishte kthyer në një akt të vërtetë pushtimi.

Në të dyja format, turqit fituan mbizotërim në vendet pritëse nëpërmjet aftësisë së tyre administruese dhe mjeshtrisë ushtarake, duke themeluar shumë shtete dhe perandori dhe duke mbajtur një pozitë të lartë për kulturën turke për shumë shekuj. (Shih. Dr. Muhammed Harb, "El-islam u fi asija el-vusta ve-l-balkan" f.9)

⁵ Ky, të paktën për kohën që qe, mund të pranohet si fillimi i historisë së popullit turk.

⁶ Referenca të shkruara për këtë gjenden në *Shāhnāmen* e Firdusit, një vepër e shekulli XII të e.s.

⁷ Në të gjithë historinë, të gjitha shtetet turke, duke përfshirë ata që u shfaqën në periudhën islame, ndoqën sistemin hunik të qeverisë.

⁸ Fakti se turqit kishin më parë një besim që quhej Gök-Tanri lehtësoi adoptimin e Islamit prej tyre pa ua zvogëluar atyre karakterin kombëtar dhe botëkuptimin. Pikat e përbashkëta midis Islamit dhe besimit në Gök-Tanri mund të përmblihet në pikat e mëposhtme:

- Një Zot
- Zoti si krijues i vetëm i gjithësisë
- Zoti si autoritet absolut
- Zoti si i gjithëditur
- Ideja e xhihadit
- Besimi në drejtësi dhe moral
- Besimi në barazinë e njeriut - Besimi në veprat e mira dhe bamirësi.

Të gjitha këto gjendeshin në filozofinë, moralin dhe besimin turk.

⁹ Xhahilijeti - injoranca, (periudha paraislamike te arabët)

¹⁰ Francesco Gabrieli, *Istoria arapske knjizhevnosti*, svjetlost Sarajevo 1985.

¹¹ *Kutub al Sitte* – gjashtë përmbledhjet më të besueshme në shkencën e hadithologjisë në botën islame.

¹² Itikaf- është një ritual fetar i muslimanëve kur besimtarët lusin Zotin duke u mënjanuar për disa kohë nga komunikimi me publikun dhe kaluar kohën më të madhe duke u falur).

¹³ Ka shumë mundësi që arabët të jenë njohur me turqit fillimisht në marrëdhëniet e tyre ushtarake me ta, një fakt i cili pasqyrohej në letërsinë arabe.

¹⁴ Muhamed Ferid Beg El-Muhami, *Tarih Ed-devle El-Il-lijje El-Uthmaiije*, f.38

¹⁵ *Po aty*, f.45

¹⁶ *A short history of Turkish – Islamic state*, f.32

¹⁷ Muhamed Ferid Beg El-Muhami, *Tarih Ed-devle El-Il-lijje El-Uthmaiije*, f.61

¹⁸ Mustafa Spahiq, *Povijest Islama*, f.400.

¹⁹ Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane*, f.270.

²⁰ Sejjid Muhammed Dikën, *Studime mbi historinë e shtetit Osman*, f.10.